Neni 27 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

27.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 7 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumën që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.

- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

- e pezullon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

27.2 Nderprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

27.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 27.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

Neni 28 Forca madhore

28.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

28.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

28.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 14 dhe 26, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e

realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 18.4 dhe 27, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dhe deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

28.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues.

28.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhrave të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mjeteve alternative sipas nenit 28.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

Neni 29 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

29.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

29.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 30 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

30.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

30.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES: kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe.
Transferimi	3	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit, transferimi lejohet vetëm me aprovimin apo miratimin e kërkesës të bërë nga kontraktuesi në AK.
Nen-kontraktimi	4	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
Dhënia e dokumenteve	5	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit dhe Njësitë kërkuese. Çdo Autoritet Kontraktues i specifikuar në Aneksin 7, brenda 5 (pese) ditëve, pas pranimit të kopjes së nënshkruar të kontratës nga Agjencia Qendrore e Prokurimit, është i obliguar që ta caktoj Menaxherin dhe ta hartoj Planin e Menaxhimit të Kontratës dhe me një kopje duhet të Njoftohet AQP-ja.
Ndihma lidhur me rregulloret vendore	6	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit.
Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit	7.1	Në AQP, Furnizuesi me shkrim do të raportoj në baza 3 (tre) mujore në 9 (nëntë) muajt e parë, ndërsa në baza mujore në 3 muajt e fundit të kontratës, lidhur me sasinë e Inventares të dorëzuara tek secili autoritet Kontraktues. Një fletë e veçante duhet të përgatitet për secilin Autoritet Kontraktues. Raporti duhet të paraqesë: <ol style="list-style-type: none"> 1. Sasinë e mallrave të dorëzuar; 2. Llojin e artikujve; 3. Datën e faturave; 4. Datën e pagesave; 5. Raportin lidhur me dëmet e likuiduara. <p>Agjencia Qendrore e Prokurimit do të hartoj një model të Raportit dhe do ta dërgoj të Furnizuesi jo më vonë se 20 dite nga nënshkrimi i kontratës. Obligohet furnizuesi që ta shfrytëzojë këtë model të Raportit gjatë raportimit të AQP-ja.</p>

		Mos raportimi me kohë pranë AQP-së nga ana e Furnizuesit, e detyron AQP-në që të marrë masa, siç është konfiskimi i garancionit të ekzekutimit dhe lëshuarja e Referencës negative për kontratën e nënshkruar.
Obligimet e përgjithshme te Furnizuesit	7.2	Operatori Ekonomik obligohet që për produktet e dorëzuara dhe të pranuar nga Njësia kërkuese të garantoj së paku 12 muaj nga data e përfundimit të kontratës dhe sa herë që i kërkohet brenda 15 ditëve duhet t'i eliminojë defektet.
Obligimet e përgjithshme te Furnizuesit	7.4 dhe 7.5	Autoriteti Kontraktues në nenin 7.4 dhe 7.5 i referohet Agjencisë Qëndrore të Prokurimit. Furnizuesi do të emërojë një përfaqësues (Menaxher), i cili do të veproje si pikë kontaktuese e Furnizuesit për të gjitha çështjet që lidhen me kontratën. Ky përfaqësues apo zëvendësi i tij duhet të jetë në dispozicion çdo here që kërkohet dhe do të këtë autoritetin e duhur për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhe çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.
Siguria e ekzekutimit	8.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 166,744.25 € me kohëzgjatje deri me datën 01.12.2025.
Përmirësimi i defekteve	9	Periudha garantuese e defekteve është 12 muaj nga përfundimi i kontratës. Brenda 10 ditëve pas përfundimit të kontratës kërkohet të ofrohet Garancia e performances për eliminimin e të metave, nga ndonjë kompani e licensuar, në shumën prej 10% të vlerës së kontratës për kohëzgjatjen e periudhës prej 12 muajve.
Sigurimi	10	Incotermi i aplikueshëm është DDP (Delivery Duty Paid).
Periudha e ekzekutimit të detyrave	12	Kurdo që ndonjëri nga Njësia e kërkesës si palë të kësaj kontrate dëshirojnë që të blejnë artikuj Inventar sipas kësaj kontrate, duhet që të dërgojnë një "Flete Porosi" tek Furnizuesi.
Zgjatja e periudhës së ekzekutimit	13	Autoriteti Kontraktues në nenin i referohet cilitdo autoritet kontraktues që shfrytëzon këtë kontratë, zgjatja e periudhës së ekzekutimit lejohet vetëm me aprovimin apo miratimin e kërkesës të bërë nga kontraktuesi në AK / Menaxheri.
Vonesat në ekzekutim	14	Autoriteti Kontraktues në nenin 7.2 i referohet cilitdo autoritet kontraktues që shfrytëzon këtë kontratë.

Vonesat ne ekzekutim	14.1	Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Njësia kërkuese (Menaxheri) , pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Njësia e Kërkesës mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti bëhen Furnizuesit. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e furnizuesit.
Suspendimi	15	Autoriteti Kontraktues në këtë nen referohet Agjencisë Qendrore te Prokurimit.
Cilësia e furnizimeve	16.1	Njësité e Kërkesës të cilat kryejnë porosinë sipas kësaj kontrate kanë të drejtë të refuzojnë çdo dërgesë të mallit i cili dështon në përmbyshjen e specifikimeve minimale te cilësisë te përcaktuara ne këtë specifikim teknik, duke njoftuar me shkrim Furnizuesin dhe AQP-në.
Cilësia e furnizimeve	16.2	Për furnizimin me artikuj Inventar Njësité e kërkesës që bëjnë porosinë nuk lëshojnë ndonjë pranim te përkohshëm. Pasi qe te shkarkohen mallrat tek Autoritetet Kontraktuese, dhe nënshkruhet fletëpranimi nga një person i autorizuar i Njësisë kërkuese malli do të konsiderohet si i pranuar përkohësisht.
Inspektimi dhe testimi	17.2	Autoriteti Kontraktues në këtë nen referohet Institucionit që bënë porosinë
Pagesat	18	Pagesa do të bëhet nga ana e secilit Autoritetit Kontraktues që bënë porosinë për artikujt vetëm në bazë të shumës së vlerës së një Urdhër Blerje te vlefshme të lëshuar nga cilido autoritetet kontraktues që bënë porosinë. Kërkesat për pagese do të bëhet vetëm për artikujt Inventar në baza mujore (ex post) sipas konsumit aktual dhe lëshimit te faturave. Brenda 10 (dhjetë) ditë pune pas dorëzimit të çdo malli, Furnizuesi duhet të dorëzoj tek institucioni një faturë origjinale dhe një kopje për artikujt të cilat janë shpërndarë dhe /ose dorëzuar gjatë muajit të tillë. Të gjitha faturat e dorëzuara duhet të deklarohen në Euro. Çdo faturë duhet të përmbajë të paktën informacionin e nevojshëm. Faturat mund të dorëzohen në formë fizike apo elektronike varësisht marrëveshjes në mes AK-së dhe kontraktuesi.
Vonesa ne pagesa	18.5	Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 18.2 do t'i japin të drejtë Furnizuesit që të ndërpresë furnizimet e mëtejme për Autoritetin kontraktues përkatës, me

		paralajmërim prej 30 ditësh për Njësinë e kërkesës përkatëse dhe Agjencinë Qendrore të Prokurimit.
Raportimi pranë AQP-së		<p>Në rast se kërkohet nga AQP-ja, Autoriteti kontraktues obligohet të raportoj me shkrim, tek Agjencia Qendrore e Prokurimit, lidhur me sasinë e artikujve Inventar të pranuar nga Kontraktuesi - Furnizuesi. Raporti duhet të paraqesë:</p> <p>Sasinë e mallrave të pranuar për periudhën e kërkuar</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Llojin e artikujve; 2. Datën e pranimi të faturave; 3. Datën e pagesave; 4. Raportin lidhur me dëmet e likuiduara. <p>Agjencia Qendrore e Prokurimit do të hartoj një model të Raportit dhe do ta dërgoj AK-së me rastin e kërkesës për raportim. Obligohet AK-ja që ta shfrytëzoj këtë model të Raportit gjatë raportimit në AQP.</p>
Dorëzimi	19.3	<p>Furnizuesi do t'i bartë të gjitha rreziqet që kanë të bëjnë me mallrat deri në pranim. Furnizimet duhet të paketohen në mënyrë që të parandalohet dëmtimi i tyre deri në destinacionin e tyre.</p> <p>Porositë dhe Dërgesat do të bëhet brenda:</p> <p>Porositë bëhen vetëm pasi Kontraktuesi pranon Urdhërblerjen zyrtarisht nga ana e Autoriteteve kontraktuese dhe duhet të bëhen sipas nevojave që autoriteti i kanë, ndërsa dërgesat apo dorëzimi i furnizimeve duhet të kryhet brenda 30 ditëve.</p> <p>Autoritetet kontraktuese do të bëjnë përpjekje që brenda 30 ditëve të kryhen pagesat nga data e pranimi të produkteve.</p> <p>Dorëzimi do të bëhet në një ditë pune dhe gjatë orarit të punës të Autoritetit kontraktues (e hënë - e premte, 8:00-16:00).</p> <p>Anulimi i porosisë:</p> <p>Autoriteti Kontraktues mund të ndryshojë apo anulojë urdhrin për furnizim me një njoftim paraprak me shkrim më së voni 24 orë para kohës së liferimit të porositur.</p>
Verifikimi i operimeve	20	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet cilitdo autoritet kontraktues që shfrytëzon këtë kontratë për porosinë e vet.
Dorëzim / pranimi dhe inspektimi i produkteve	20.1	Furnizimet nuk do të pranohen derisa të jenë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave. Produktet e dorëzuara nga kontraktori dhe të pranuar nga Njësia kërkuuese duhet të janë në përputhje me standardet mbi specifikimet teknike.
Pranimi i përkohshëm	21	Institucionet që shfrytëzojnë këtë kontratë nuk lëshojnë ndonjë pranim të përkohshëm.

Obligimet e garancionit	22.1	Furnizuesi do të garantojë që furnizimet të jenë të reja, të papërdorura, të modeleve të fundit dhe të përfshijë të gjitha përmirësimet e kohëve të fundit në dizajn dhe materiale. Furnizuesi do të garantojë që asnjë nga furnizimet të mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshhtëria. Operatori Ekonomik obligohet që për produktet e dorëzuara dhe të pranuar nga Njësia kërkuese të garantoj së paku 12 muaj dhe sa herë që i kërkohet brenda 15 ditëve duhet t'i eliminojë defektet.
Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues	26	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit me propozimin e Njësive kërkuese/ Autoritetit kontraktues që shfrytëzon këtë kontratë.
Ndërprerja e Kontratës nga Furnizuesi	27	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet cilitdo Njësi e kërkesës/ Autoritet kontraktues që shfrytëzon këtë kontratë
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.1	Autoriteti Kontraktues në këtë nen i referohet Agjencisë Qendrore të Prokurimit. Njësia e kërkesës duhet të bëjë përpjekje të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me Furnizuesin.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	29.2	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore , përgjegjës për zgjidhjen e tyre do të jenë personat përgjegjës të Njesisë së Kërkesës/Institucionit që shfrytëzon këtë kontratë dhe zyrtaret përgjegjës që shfrytëzojnë kontratën dhe personat përgjegjës të ofruesit të shërbimeve. AQP vetëm jep ndihmë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve eventuale.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	30.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën themelore në Prishtinë, në pajtim me ligjet e Kosovës.

Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

Sipas nenit 94 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës është themeluar Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP).

AQP sipas Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, është përgjegjëse për:

- ✓ Zhvillimin e prokurimeve të përbashkëta për Njësitë Kërkuese;
- ✓ Me kërkesën e Njësive Kërkuese, kryen aktivitetet e prokurimit në emër të tyre; dhe
- ✓ Me kërkesën e Njësive Kërkuese, ndihmon në kryerjen e aktiviteteve të prokurimit.

Autoriteti Kontraktues (Agjencia Qendrore e Prokurimit) është duke identifikuar furnizuesit që do të kenë kapacitetin për të furnizuar me produkte inventarit për Autoritetet Kontraktuese të identifikuar në Aneksin 7. Furnizuesit do të jenë përgjegjës për menaxhimin e plotë të furnizimit për Autoritetet Kontraktuese të identifikuar në Aneksin 7.

Rreziku i humbjes apo dëmtimit, të produkteve të inventarit nga cilido shkak do të jetë mbi Furnizuesin dhe do të përballohet nga Furnizuesi deri në kohën kur mallrat të dorëzohen në pronësi të AK. Produktet e dorëzuara nga kontraktori dhe të pranuar duhet të janë në përputhje me EN & ISO standardet mbi specifikacionet teknike.

AK të cilat janë të identifikuar në Aneksin 7 kanë të drejtë të refuzojnë çdo dërgesë e cila dështon në përmbushjen e specifikimeve minimale të cilësisë të përcaktuara në këtë specifikim teknik.

Agjencia Qendrore e Prokurimit pas nënshkrimit të kontratës do të shpërndaje nga një kopje të nënshkruar të kontratës tek secili Autoritet Kontraktues i identifikuar në Aneksin 7. Një kopje e kontratës së nënshkruar do të publikohet në webfaqen e AQP-se.


Furnizuesi do të emërojë një përfaqësues, i cili do të veprojë si pikë kontaktuese e Furnizuesit për të gjitha çështjet që lidhen me kontratën. Ky përfaqësues apo zëvendësi i tij do të ketë autoritetin e duhur për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhë çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.

Çdo AK i specifikuar në Aneksin 7 do të emërojë një përfaqësues si pikë ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe OE i cili do të ketë autoritetin për të marrë vendime të shpejta dhe të zgjidhë çështjet që lidhen me ekzekutimin e kontratës.




Garancioni për secilin artikull është 12 muaj nga pranimi i mallit.




Devijimi i lejuar në dimension është +/- 5 % si për tavolina, dollapë dhe karriga zyrtare. Inventari duhet të jetë komfor specifikimeve teknike të specifikuar më poshtë dhe komfor standardeve.






Fotot janë vetëm për ilustrim, obligative është të plotësohet kërkesat e paraqitura tek "përshkrimi"













Lot 3 - Furnizim me inventar shkollorë




Nr.	Pershkrimi	Foto-ja,
1	<p>Banka per nxenes te nivelit klasor prej 1-5, me dimensione 60x120x65cm, e punuar nga konstruksion tuba metalik, ne forme elipse 45x35x2 mm, e ngjyrosur me ngjyre elektrostatiqe, kendet e konstruksionit dhe vrimat e tubave te mbuloohen me plastika ne baze te fotos. Pjesa mbajtese e librave te punohet nga metariali si ne foto ose me rrjetë metalike. Pllaka e bankes e punuar nga pllake kompensato nga fletet e rimesos se drurit ta ahut, me trashësi 22mm, e veshur ne sipërfaqe me kompaktlaminat me trashësi 0.8mm te jetë e llakuar, skajet e bankës te jene të zbukuruara dhe të lakuara. Profilet e brinjëve te pllakes te kene nje rreze prej 5 mm, ndersa kendet te kene nje rreze harkore prej 30mm. Ngjyrat do te caktohet nga mbikëqyrësi. Per çdo dimension lejohet (+-) 5 %</p>	
2	<p>Banka per nxenes te nivelit klasor prej 6-9, me dimensione 60x120x70cm, e punuar nga konstruksion tuba metalik, ne forme elipse 45x35x2 mm, e ngjyrosur me ngjyre elektrostatiqe, kendet e konstruksionit dhe vrimat e tubave te mbuloohen me plastika ne baze te fotos. Pjesa mbajtese e librave te punohet nga metariali, si ne foto ose me rrjetë metalike. Pllaka e bankës e punuar nga pllake kompensato nga fletët e rimesos se drurit ta ahut, me trashësi 22mm, e veshur ne sipërfaqe me kompaktlaminat me trashësi 0.8mm te jetë e llakuar, skajet e bankës te jene të zbukuruara dhe të lakuara. Profilet e brinjëve te pllakës te kene nje rreze prej 5 mm, ndersa kendet te kene nje rreze harkore prej 30mm. Ngjyrat do te caktohet nga mbikëqyrësi. Per çdo dimension lejohet (+-) 5 %</p>	
3	<p>Banka për nxënës te nivelit klasor prej 10-12, me dimensione 60x120x75cm, e punuar nga konstruksion tuba metalik, ne forme elipse 45x35x2 mm, e ngjyrosur me ngjyre elektrostatiqe, kendet e konstruksionit dhe vrimat e tubave te mbuloohen me plastika ne baze te fotos. Pjesa mbajtese e librave te punohet nga metariali, si ne foto ose me rrjetë metalike. Pllaka e bankës e punuar nga pllake kompensato nga fletët e rimesos se drurit ta ahut, me trashësi 22mm, e veshur ne sipërfaqe me kompaktlaminat me trashësi 0.8mm te jetë e llakuar, skajet e bankës te jene të zbukuruara dhe të lakuara. Profilet e brinjëve te pllakes te kene nje rreze prej 5 mm, ndersa kendet te kene nje rreze harkore prej 30mm. Ngjyrat do te caktohet nga mbikëqyrësi. Per çdo dimension lejohet (+-) 5 %</p>	

4	<p>Karriga per nxenes te nivelit klasor prej 1-5 , me dimensione 37x37x40/75cm, e punuar nga konstruksion tuba metalik, ne forme elipse 40x20x2 mm, e ngjyrosur me ngjyre elektrostatiqe, kendet e konstruksionit dhe vrimat e tubave te mbulohen me plastika ne baze te fotos. Ulesja dhe mbeshtetesja e karriges e punuar nga pllake kompensato nga fletet e rimesos se drurit ta ahut, me trashesi 8mm. Profilet e brinjeve te pllakes te kene nje rreze prej 2 mm, ndersa kendet te kene nje rreze harkore prej 10-30mm. Perpunimi siperfaqesor te behet me llak poliuretan ne dy shtresa(baza dhe shtresa finale). Ngjyrat do te caktohet nga mbikëqyrësi. Per çdo dimension lejohet (+-) 5 %</p>	
5	<p>Karriga per nxenes te nivelit klasor prej 6-9, me dimensione 40x40x42/75cm, e punuar nga konstruksion tuba metalik, ne forme elipse 40x20x2 mm, e ngjyrosur me ngjyre elektrostatiqe, kendet e konstruksionit dhe vrimat e tubave te mbulohen me plastika ne baze te fotos. Ulesja dhe mbeshtetesja e karriges e punuar nga pllake kompensato nga fletet e rimesos se drurit ta ahut, me trashesi 8mm. Profilet e brinjeve te pllakes te kene nje rreze prej 2 mm, ndersa kendet te kene nje rreze harkore prej 10-30mm. Perpunimi siperfaqesor te behet me llak poliuretan ne dy shtresa(baza dhe shtresa finale). Ngjyrat do te caktohet nga mbikëqyrësi. Per çdo dimension lejohet (+-) 5 %</p>	
6	<p>Karriga per nxenes te nivelit klasor prej 10-12, me dimensione 40x40x44/75cm, e punuar nga konstruksion tuba metalik, ne forme elipse 40x20x2 mm, e ngjyrosur me ngjyre elektrostatiqe, kendet e konstruksionit dhe vrimat e tubave te mbulohen me plastika ne baze te fotos. Ulesja dhe mbeshtetesja e karriges e punuar nga pllake kompensato nga fletet e rimesos se drurit ta ahut, me trashesi 8mm. Profilet e brinjeve te pllakes te kene nje rreze prej 2 mm, ndersa kendet te kene nje rreze harkore prej 10-30mm. Perpunimi siperfaqesor te behet me llak poliuretan ne dy shtresa(baza dhe shtresa finale). Ngjyrat do te caktohet nga mbikëqyrësi. Per çdo dimension lejohet (+-) 5 %</p>	

7	<p>Tavoline per mesimedhemes ne klase, me dimensione 60x120x75cm, e punuar nga konstruksion tuba metalik, ne forme ellipse 45x35x2 mm, e ngjyrosur me ngjyre elektrostатike, kendet e konstruksionit dhe vrimat e tubave te mbulohen me plastika ne baze te fotos. Pjesa ballore dhe nje sirtar te punohet nga metarjali, forma si ne foto. Pllaka e bankes e punuar nga pllake kompensato nga fletet e rimesos se drurit ta ahut, me trashesi 22mm, e veshur ne sipërfaqe me kompaktlaminat me trashesi 0.8mm te jetë e llakuar, skajet e bankës te jene të zbkuruara dhe të lakuara. Profilet e brinjeve te pllakes te kene nje rreze prej 5 mm, ndersa kendet te kene nje rreze harkore prej 30mm.</p> <p>Per çdo dimension lejohet (+-) 10 %</p>	
8	<p>Karriga per salle te mesimedhemesve, me dimensione 44x44x44/75cm, e punuar nga konstruksion tuba metalik, ne forme ellipse 30x15x1.5 mm, e ngjyrosur me ngjyre krom, kendet e konstruksionit dhe vrimat e tubave te mbulohen me plastika ne baze te fotos. Ulesja dhe mbeshtetesja e karriges e punuar nga plastika e veshur me shpuze te kallupuar dhe shtof i thurrur, e mbuluar me kapak platike.</p>	
9	<p>Karrige per Arsimitar / Student, e punuar nga konstruksioni nga metali Ø 20 mm, me trashesi te murit d=2 mm, e ngjyrosur me ngjyre elektrostатike, Ulese dhe mbeshtetese prej nje tersie nga druri i shtanguar (rimeso), me trashesi d= 8mm, e llakuar me llak poliuretane mat, ti vendosen gomate ne kembet per ruajtjen e dyshemes.</p> <p>Dimensione 40x40x44/75cm, Per çdo dimension lejohet (+-) 10 %</p>	
10	<p>Tavoline per sallën e mbledhjeve, me dimensione 140x360x74cm, konstruksioni nga metali i kromuar, forma si ne foto, pllaka te jete e punuar nga pllake MDF e fisnikeruar ose e ngjyrosur, me dizajn si ne foto, me trashesi 36mm, Profilet e brinjeve te pllakes te kene nje rreze prej 10 mm, ndersa kendet te kene nje rreze harkore prej 30mm. Perpunimi siperfaqesor te behet me llak ose ngjyre poliuretane ne dy shtresa (baza dhe shtresa finale).</p> <p>Per çdo dimension lejohet (+-) 10 %</p>	
11	<p>Tavoline per sallën e IT, me dimensione 70x130x74cm, konstruksioni nga metali i kromuar, forma si ne foto, pllaka te jete e punuar nga pllake MDF e fisnikeruar ose e ngjyrosur, me dizajn si ne foto, me trashesi 36mm, Profilet e brinjeve te pllakes te kene nje rreze prej 10 mm, ndersa kendet te kene nje rreze harkore prej 30mm. Perpunimi siperfaqesor te behet me llak ose ngjyre poliuretane ne dy shtresa (baza dhe shtresa finale).</p> <p>Per çdo dimension lejohet (+-) 10 %</p>	

12	<p>Sirtar me 3 fioka me mbyllje qendrore, per tavoline pune, e punuar nga pllake zdrukthi melamine treshtresore, me perde mbrojtese ne pjesen e perparme, ngjyra e perzgjedhur nga autoriteti kontraktues ,me peshe specifike prej 850kg/m³, me trashes d=18 mm, ndersa brinjet e pllakes te mveshura me shirit ABS me trashesi d= 2 mm, me rreze r=2mm, ne pjesen e poshtme me rroteza plastike, me diameter 50 mm, rreshqitesa teleskopik per sirtare, ndersa doreza kualitative te kromuara. Per çdo dimension lejohet (+-) 10 %</p>	
13	<p>ULSE PËR PRITJE: Ulese per pritje 3/1 ne holl, te punuara nga pllake kompensate dymbedhjeteshresore, ngjyra natyrale dru ahur, me trashesi d=10 mm, te vendosura nga tri cope ne nje rend, konstruksioni te punohet nga tuba metalik 40x40 mm, me muri te tubit 2 mm, ne pjesen e sipërme e lidhur ne mes vete me tuba te njejte. Ngjyrosje elektrostatische e zeze, ne pjesen e poshtme te vendosen kembesha plastike me mundesi rregullimi te nivelit.</p>	
14	<p>Vitrine e mbyllur, me çeles ne njerën dërë, me dimensione (80 x 40 x 200cm), e punuar nga pllake zdrukthi melamine treshtresore, ngjyra e perzgjedhur nga autoriteti kontraktues, me trashes d=18 mm, ndersa brinjet e pllakes te mveshura me shirit ABS me trashesi d= 2 mm, me rreze r=2mm, ne pjesen e brendshme pesë hapësira per dosje, ndersa ne dyer te vendosen doreza kualitative te kromuara. Per çdo dimension lejohet (+-) 10 %</p>	
15	<p>Vitrine e mbyllur, ne pjesën e sipërme e hapur, me çeles ne njerën dërë, me dimensione (80 x 40 x 200cm),e punuar nga pllake zdrukthi melamine treshtresore, ngjyra e perzgjedhur nga autoriteti kontraktues, me trashes d=18 mm, ndersa brinjet e pllakes te mveshura me shirit ABS me trashesi d= 2 mm, me rreze r=2mm, ne pjesen e brendshme tre hapësira per dosje, ndersa ne dyer te vendosen doreza kualitative te kromuara. Per çdo dimension lejohet (+-) 10 %</p>	
16	<p>Vitrine e hapur, me dimensione (80 x 40 x 200cm), e punuar nga pllake zdrukthi melamine treshtresore, ngjyra e perzgjedhur nga autoriteti kontraktues, me trashes d=18 mm, ndersa brinjet e pllakes te mveshura me shirit ABS me trashesi d=2 mm, me rreze r=2mm, ne pjesen e brendshme. pesë (5) hapësira per dosje. Per çdo dimension lejohet (+-) 5 %</p>	

17	<p>Vitrinë e mbyllur me kornize druri me qelq, me çeles ne njerën dërë, me dimensione (80 x 40 x 200cm), e punuar nga pllakë zdrukthi melamine treshtresore, ngjyra e perzgjedhur nga autoriteti kontraktues, me trashësi d=18 mm, ndërsa brinjët e pllakës të mveshura me shirit ABS me trashësi d=2 mm, me rreze r=2mm, e punuar sipas dizajnit në foto, me gjashtë (6) hapësira për dosje, ndërsa në dyer të vendosen dorëza kualitative të kromuara.</p> <p>Per çdo dimension lejohe (+-) 5 %</p>	
18	<p>Vitrinë e mbyllur me dyer në pjesën e poshtme, me çeles në njerën dërë, ndërsa në pjesën e epërme me dyer qelqi, hapësirë për dy folla, me dimensione (80 x 40 x 200cm), e punuar nga pllakë zdrukthi melamine treshtresore, ngjyra e perzgjedhur nga autoriteti kontraktues, me trashësi d=18 mm, ndërsa brinjët e pllakës të mveshura me shirit ABS me trashësi d= 2 mm, me rreze r=2mm, në pjesën e brendshme tre hapësira për dosje, ndërsa në dyer të vendosen dorëza kualitative të kromuara.</p> <p>Per çdo dimension lejohe (+-) 10 %</p>	
19	<p>Dërrasë e kombinuar: e bardhë magnetike me dimensione 150x100cm; e zeza magnetike 300x100cm; aksesoret: rreshqitesa alumini- dërrasa e bardhë levizëse, mbajtëse alumini për markera.</p>	
20	<p>Dërrasë e bardhë magnetike me dimensione 220x100cm; mbajtëse alumini për markera.</p>	
21	<p>Dërrasë muri me shtresë të bute (tapë), si në foto, me trashësi min. 1.8cm, me dimensione 120x90cm.</p>	

22	<p>Tabela shkrimi (shkollore), me dimensione (120x240) nga MDF I presuar dhe I plastifikuar, me foli ngjyrë të gjelbër, e përshtatshme për shkrim. Tabela duhet ta ketë kornizën nga alumini profil U, mbajtësen për shpuzë. Trashësia e tabelës d=1,8cm.</p>	
23	<p>Raft metalik për arkiv me dim. min. 2000*900*450mm. Te ket nje ndarje si ne foto .1. Nënshtrësia: E bërë nga pllakë çeliku e mbështjellë me cilësi të lartë, tashësia e metit ne shtylla te jete: 1.6mm, gjdo ansore apo ndarje te kete edhe vrima per mundesi te rregullimit te raftave sipas nevojës</p>	 <p>2000 x 900 x 450mm</p>
24	<p>Rafta me Metalik për arkiv me dim. Min. 1830*900*450mm. 1. Nënshtrësia: E bërë nga pllakë çeliku e mbështjellë me cilësi të lartë, 2. Trashësia:1.3mm gjdo ansore te kete edhe vrima per mundesi te rregullimit te raftave sipas nevojës</p>	 <p>1830 x 900 x 450mm</p>


25

Dollap metlaik me 18 dyer , dim. i dollapit 1800*900*360mm. 1. Nënshtrësia: E bërë nga pllakë çeliku e mbështjellë me cilësi të lartë,

2. Trashësia:0.6mm, secila nga dyert te ken 2 qelsa

3. Aksesorë harduerikë: Doreza është një lloj kombinimi i shtrëngimit të fshehur, i bërë nga aliazh alumini, i bukur dhe i qëndrueshëm; Të gjithë aksesorët harduerikë trajtohen me parandalimin e ndryshkut dhe korrozionit, duke përmbushur standardet kombëtare.

4. Procesi: Saldim me frekuencë të lartë, me sipërfaqe saldimi uniforme dhe konsistente, pa spërkatje, shkrire, Saldim Profesional, depërtim saldimi dhe dukuri të tjera. Të gjitha sipërfaqet kanë pesë shenja saldimi të dukshme. Çdo komponent i nënshtrëhet proceseve të tilla si heqja e ndryshkut dhe tharja; Duke përdorur spërkatje elektrostatische me pluhur rrëshirë epoksi që ka kaluar inspektimin SGS, është miqësor me mjedisin, jo toksik dhe pa erë. E bukur dhe bujare, e ndritshme dhe e sheshtë, pa grimca, fluska ose njolla skorje në sipërfaqe dhe ngjyrë uniforme; Sipërfaqja e kabinetit ka avantazhe të tilla si rezistenca ndaj presionit, forcë e lartë, e papërshkueshme nga uji, kundër ndotjes, rezistencë ndaj goditjes, jo deformueshmëri, rezistente ndaj lagështirës dhe kundër korrozionit.



1800 x 900 x 360mm


26

Dollap metalik i sigurise se larte , me dim 1850*900*420mm. 1. Nënshtrësia: E bërë nga pllakë çeliku e mbështjellë me cilësi të lartë,

2. Trashësia:0.6mm, secila nga dyert te ken 2 qelsa

3. Aksesorë harduerikë: Doreza është një lloj kombinimi i shtrëngimit të fshehur, i bërë nga aliazh alumini, i bukur dhe i qëndrueshëm; Të gjithë aksesorët harduerikë trajtohen me parandalimin e ndryshkut dhe korrozionit, duke përmbushur standardet kombëtare.

4. Procesi: Saldim me frekuencë të lartë, me sipërfaqe saldimi uniforme dhe konsistente, pa spërkatje, shkrire, Saldim Profesional, depërtim saldimi dhe dukuri të tjera. Të gjitha sipërfaqet kanë pesë shenja saldimi të dukshme. Çdo komponent i nënshtrëhet proceseve të tilla si heqja e ndryshkut dhe tharja; Duke përdorur spërkatje elektrostatische me pluhur rrëshirë epoksi që ka kaluar inspektimin SGS, është miqësor me mjedisin, jo toksik dhe pa erë. E bukur dhe bujare, e ndritshme dhe e sheshtë, pa grimca, fluska ose njolla skorje në sipërfaqe dhe ngjyrë uniforme; Sipërfaqja e kabinetit ka avantazhe të tilla si rezistenca ndaj presionit, forcë e lartë, e papërshkueshme nga uji, kundër ndotjes, rezistencë ndaj goditjes, jo deformueshmëri, rezistente ndaj lagështirës dhe kundër korrozionit



1850 x 900 x 420mm

27

Dollap Metalik per personel me 4 dyer me dim.
1850*900*420mm. 1. Nënshtrësia: E bërë nga pllakë çeliku e mbështjellë me cilësi të lartë,

2. Trashësia: 0.6mm, secila nga dyert te ken 2 çelësa


3. Aksesorë harduerikë: Doreza është një lloj kombinimi i shtrëngimit të fshehur, i bërë nga aliazh alumini, i bukur dhe i qëndrueshëm; Të gjithë aksesorët harduerikë trajtohen me parandalimin e ndryshkut dhe korrozionit, duke përmbushur standardet kombëtare.

4. Procesi: Saldim me frekuencë të lartë, me sipërfaqe saldimit uniforme dhe konsistente, pa spërkatje, shkrirje, Saldim Profesional, depërtim saldimit dhe dukuri të tjera. Të gjitha sipërfaqet kanë pesë shenja saldimit të dukshme. E bërë prej çeliku të mbështjellë të ftohtë me cilësi të lartë, përmban ujë, rezistent ndaj lagështirës dhe kundër zjarrit, i lehtë për tu pastruar dhe mirëmbajtur.


Ideale për dhomat e zhveshjes sportive ose për shkolla, me 6 ndarje të veçanta me dyer, çdo ndarje ka një pasqyrë.

Hapësirë e bollshme për ruajtjen e rrobave dhe sendeve të tjera personale të sigurta. Në mes të çdo grilë ka një ndarje, e cila ndahet në dy shtresa. Shtresa e poshtme mund të përdoret për këpucë, etj.

Me një kënd hapjeje prej 130° dhe 8 çelësa, kapaciteti maksimal i ngarkesës për raft: 10 kg





1850 x 900 x 420mm



28


Dollap Metalik per personel me 12 dyer me dim.
1850*900*420mm. 1. Nënshtrësia: E bërë nga pllakë çeliku e mbështjellë me cilësi të lartë,
2. Trashësia:0.6mm, secila nga dyert te ken 2 qelsa
3. Aksesorë harduerikë: Doreza është një lloj kombinimi i shtrengimit të fshehur, i bërë nga aliazh alumini, i bukur dhe i qëndrueshëm; Të gjithë aksesorët harduerikë trajtohen me parandalimin e ndryshkut dhe korrozionit, duke përbushur standardet kombëtare.
4. Procesi: Saldim me frekuencë të lartë, me sipërfaqe saldimi uniforme dhe konsistente, pa spërkatje, shktrije, Saldim Profesional, depërtim saldimi dhe dukuri të tjera. Të gjitha sipërfaqet kanë pesë shenja saldimi të dukshme. Çdo komponent i nënshtrëhet proceseve të tilla si heqja e ndryshkut dhe tharja; Duke përdorur spërkatje elektrostatische me pluhur rrëshirë epoksi që ka kaluar inspektimin SGS, është miqësor me mjedisin, jo toksik dhe pa erë. E bukur dhe bujate, e ndritshme dhe e sheshtë, pa grimca, flluska ose njolla skorje në sipërfaqe dhe ngjyrë uniforme; Sipërfaqja e kabinetit ka avantazhe të tilla si rezistenca ndaj presionit, forcë e lartë, e papërshkueshme nga uji, kundër ndotjes, rezistencë ndaj goditjes, jo deformueshmëri, rezistente ndaj lagështirës dhe kundër korrozionit.



1850 × 900 × 420mm

29


Dollap Metalik per personel me 6 dyer me dim.
1000*900*400mm. 1. Nënshtrësia: E bërë nga pllakë çeliku e mbështjellë me cilësi të lartë,
2. Trashësia:0.6mm, secila nga dyert te ken 2 qelsa
3. Aksesorë harduerikë: Doreza është një lloj kombinimi i shtrengimit të fshehur, i bërë nga aliazh alumini, i bukur dhe i qëndrueshëm; Të gjithë aksesorët harduerikë trajtohen me parandalimin e ndryshkut dhe korrozionit, duke përbushur standardet kombëtare.
4. Procesi: Saldim me frekuencë të lartë, me sipërfaqe saldimi uniforme dhe konsistente, pa spërkatje, shktrije, Saldim Profesional, depërtim saldimi dhe dukuri të tjera. Të gjitha sipërfaqet kanë pesë shenja saldimi të dukshme. Çdo komponent i nënshtrëhet proceseve të tilla si heqja e ndryshkut dhe tharja; Duke përdorur spërkatje elektrostatische me pluhur rrëshirë epoksi që ka kaluar inspektimin SGS, është miqësor me mjedisin, jo toksik dhe pa erë. E bukur dhe bujate, e ndritshme dhe e sheshtë, pa grimca, flluska ose njolla skorje në sipërfaqe dhe ngjyrë uniforme; Sipërfaqja e kabinetit ka avantazhe të tilla si rezistenca ndaj presionit, forcë e lartë, e papërshkueshme nga uji, kundër ndotjes, rezistencë ndaj goditjes, jo deformueshmëri, rezistente ndaj lagështirës dhe kundër korrozionit.




1000 × 900 × 400mm

30

Dollap Metalik per personel me 9 dyer me dim. 1850*900*420mm. 1. Nënshtrësia: E bërë nga pllakë çeliku e mbështjellë me cilësi të lartë,
2. Trashësia:0.6mm, secila nga dyert te ken 2 qelsa
3. Aksesorë harduerikë: Doreza është një lloj kombinimi i shtrëngimit të fshehur, i bërë nga aliazh alumini, i bukur dhe i qëndrueshëm; Të gjithë aksesorët harduerikë trajtohen me parandalimin e ndryshkut dhe korrozionit, duke përmbyshur standardet kombëtare.
4. Procesi: Saldim me frekuencë të lartë, me sipërfaqe saldimit uniforme dhe konsistente, pa spërkatje, shkiritje, Saldim Profesional, depërtim saldimit dhe dukuri të tjera. Të gjitha sipërfaqet kanë pesë shenja saldimit të dukshme. Çdo komponent i nënshtrëhet proceseve të tilla si heqja e ndryshkut dhe tharja; Duke përdorur spërkatje elektrostatische me pluhur rrëshirë epoksi që ka kaluar inspektimin SGS. E bërë prej çeliku të mbështjellë të ftohtë me cilësi të lartë, përmban ujë, rezistent ndaj lagështirës dhe kundër zjarrit, i lehtë për tu pastruar dhe mirëmbajtur.
Ideale për dhomat e zhveshjes sportive ose për shkolla, me 6 ndarje të veçanta me dyer, çdo ndarje ka një pasqyrë.
Hapësirë e bollshme për ruajtjen e rrobave dhe sendeve të tjera personale të sigurta. Në mes të çdo grilë ka një ndarje, e cila ndahet në dy shtresa. Shtresa e poshtme mund të përdoret për këpucë, etj.
Me një kënd hapjeje prej 130° dhe 9 çelësa, kapaciteti maksimal i ngarkesës për raft: 10 kg




1850 x 900 x 420mm







31

Dollap metalik me 2 dyer me dim 1800*850*420 mm . 1. Nënshtrësia: E bërë nga pllakë çeliku e mbështjellë me cilësi të lartë,
2. Trashësia:0.6mm, secila nga dyert te ken 2 qelsa
3. Aksesorë harduerikë: Doreza është një lloj kombinimi i shtrëngimit të fshehur, i bërë nga aliazh alumini, i bukur dhe i qëndrueshëm; Të gjithë aksesorët harduerikë trajtohen me parandalimin e ndryshkut dhe korrozionit, duke përmbyshur standardet kombëtare.
4. Procesi: Saldim me frekuencë të lartë, me sipërfaqe saldimit uniforme dhe konsistente, pa spërkatje, shkiritje, Saldim Profesional, depërtim saldimit dhe dukuri të tjera. Të gjitha sipërfaqet kanë pesë shenja saldimit të dukshme. Çdo komponent i nënshtrëhet proceseve të tilla si heqja e ndryshkut dhe tharja; Duke përdorur spërkatje elektrostatische me pluhur rrëshirë epoksi që ka kaluar inspektimin SGS. E bërë prej çeliku të mbështjellë të ftohtë me cilësi të lartë, përmban ujë, rezistent ndaj lagështirës dhe kundër zjarrit, i lehtë për tu pastruar dhe mirëmbajtur.
Ideale për zyra apo edhe në salla të arsimitarve
Hapësirë e bollshme për ruajtjen e rrobave dhe sendeve të tjera personale të sigurta. Në mes të çdo grilë ka një ndarje, e cila ndahet në dy shtresa. Shtresa e poshtme mund të përdoret për këpucë, etj.
Me një kënd hapjeje prej 130° dhe 2 çelësa, kapaciteti maksimal i ngarkesës për raft: 10 kg




1800 x 850 x 420mm



32	<p>Dollap metalik per zyre me dim 1800*850*390 mm. 1. Nënshtrësia: E bërë nga pllakë çeliku e mbështjellë me cilësi të lartë, secila nga dyert te ken 2 qelsa</p> <p>2. Trashësia: 0.6mm te ket dy ndarje dhe organizimi i tyre mbrenda organizimi i hapsires te jete si ne foto</p> <p>3. Aksesorë harduerikë: Doreza është një lloj kombinimi i shtrëngimit të fshehur, i bërë nga aliazh alumini, i bukur dhe i qëndrueshëm; Të gjithë aksesorët harduerikë trajtohen me parandalimin e ndryshkut dhe korrozionit, duke përmbushur standardet kombëtare.</p> <p>4. Procesi: Saldim me frekuencë të lartë, me sipërfaqe saldimi uniforme dhe konsistente, pa spërkatje, shkrire, Saldim Profesional, depërtim saldimi dhe dukuri të tjera. Të gjitha sipërfaqet kanë pesë shenja saldimi të dukshme.</p>	
33	<p>Dollap Metalik per personel me 6 dyer me dim. 1850*900*420mm. 1. Nënshtrësia: E bërë nga pllakë çeliku e mbështjellë me cilësi të lartë,</p> <p>2. Trashësia: 0.6mm secila nga dyert te ken 2 qelsa</p> <p>3. Aksesorë harduerikë: Doreza është një lloj kombinimi i shtrëngimit të fshehur, i bërë nga aliazh alumini, i bukur dhe i qëndrueshëm; Të gjithë aksesorët harduerikë trajtohen me parandalimin e ndryshkut dhe korrozionit, duke përmbushur standardet kombëtare.</p> <p>4. Procesi: Saldim me frekuencë të lartë, me sipërfaqe saldimi uniforme dhe konsistente, pa spërkatje, shkrire, Saldim Profesional, depërtim saldimi dhe dukuri të tjera. Të gjitha sipërfaqet kanë pesë shenja saldimi të dukshme. Çdo komponent i nënshtrohet proceseve të tilla si heqja e ndryshkut dhe tharja; Duke përdorur spërkatje elektrostatische me pluhur rrëshirë epoksi që ka kaluar inspektimin SGS, është miqësor me mjedisin, jo toksik dhe pa erë. E bukur dhe bujare, e ndritshme dhe e sheshtë, pa grimca, flluska ose njolla skorje në sipërfaqe dhe ngjyrë uniforme; Sipërfaqja e kabinetit ka avantazhe të tilla si rezistenca ndaj presionit, forcë e lartë, e papërshkueshme nga uji, kundër ndotjes, rezistenca ndaj goditjes, jo deformueshmëri, rezistente ndaj lagështirës dhe kundër korrozionit.</p>	 <p>1850 x 900 x 420mm</p> 
34	<p>Dollap Metalik per Foldera pjesa posht me dyer nga metali ndersa pjesa sipër me dyer te xhamit. Dim. 1850*900*400mm. 1. Nënshtrësia: E bërë nga pllakë çeliku e mbështjellë me cilësi të lartë,</p> <p>2. Trashësia: 0.6mm, dyert sipër te punohet nga nje korniz form drejtkendshme me llamarine 0.6mm dhe te ket hapsiren oper xham me trashesi 3mm</p> <p>3. Aksesorë harduerikë: Doreza është një lloj kombinimi i shtrëngimit të fshehur, i bërë nga aliazh alumini, i bukur dhe i qëndrueshëm; Të gjithë aksesorët harduerikë trajtohen me parandalimin e ndryshkut dhe korrozionit, duke përmbushur standardet kombëtare.</p> <p>4. Procesi: Saldim me frekuencë të lartë, me sipërfaqe saldimi uniforme dhe konsistente, pa spërkatje, shkrire, Saldim Profesional, depërtim saldimi dhe dukuri të tjera. Të gjitha sipërfaqet kanë pesë shenja saldimi të dukshme. Çdo komponent i nënshtrohet proceseve të tilla si heqja e ndryshkut dhe tharja; Duke përdorur spërkatje elektrostatische me pluhur rrëshirë epoksi që ka kaluar inspektimin SGS.</p>	


35





Dollap Metalik per Foldera me dyer nga xhami. Dim. 1850*900*400mm. 1. Nënshtrësia: E bërë nga pllakë çeliku e mbështjellë me cilësi të lartë,
 2. Trashësia: 0.6mm dyert te punohet nga nje korniz form drejtkendshme me llamarine 0.6mm dhe te ket hapsiren oper xham me trashesi 3mm
 3. Aksesorë harduerikë: Doreza është një lloj kombinimi i shtrëngimit të fshehur, i bërë nga aliazh alumini, i bukur dhe i qëndrueshëm; Të gjithë aksesorët harduerikë trajtohen me parandalimin e ndryshkut dhe korrozionit, duke përmbushur standardet kombëtare.
 4. Procesi: Saldim me frekuencë të lartë, me sipërfaqe saldimi uniforme dhe konsistente, pa spërkatje, shkrire, Saldim Profesional, depërtim saldimi dhe dukuri të tjera. Të gjitha sipërfaqet kanë pesë shenja saldimi të dukshme. Çdo komponent i nënshtrohet proceseve të tilla si heqja e ndryshkut dhe tharja; Duke përdorur spërkatje elektrostatische me pluhur rrëshirë epoksi që ka kaluar inspektimin SGS, është miqësor me mjedisin, jo toksik dhe pa erë. E bukur dhe bujare, e ndritshme dhe e sheshtë, pa grimca, fluska ose njolla skorje në sipërfaqe dhe ngjyrë uniforme; Sipërfaqja e kabinetit ka avantazhe të tilla si rezistenca ndaj presionit, forcë e lartë, e papërshkueshme nga uji, kundër ndotjes, rezistencë ndaj goditjes, jo deformueshmëri, rezistente ndaj lagështirës dhe kundër korrozionit.



36

Dollap metalik me dyer rreshqitese nga te dy anet me dim. 1090*900*400mm. 1. Nënshtrësia: E bërë nga pllakë çeliku e mbështjellë me cilësi të lartë,
 2. Trashësia: 0.6mm, dyert te rreshqitese nga te dy anet dhe me qeles,
 3. Aksesorë harduerikë: Doreza është një lloj kombinimi i shtrëngimit të fshehur, i bërë nga aliazh alumini, i bukur dhe i qëndrueshëm; Të gjithë aksesorët harduerikë trajtohen me parandalimin e ndryshkut dhe korrozionit, duke përmbushur standardet kombëtare.
 4. Procesi: Saldim me frekuencë të lartë, me sipërfaqe saldimi uniforme dhe konsistente, pa spërkatje, shkrire, Saldim Profesional, depërtim saldimi dhe dukuri të tjera. Të gjitha sipërfaqet kanë pesë shenja saldimi të dukshme. Sipërfaqja e kabinetit ka avantazhe të tilla si rezistenca ndaj presionit, forcë e lartë, e papërshkueshme nga uji, kundër ndotjes, rezistencë ndaj goditjes, jo deformueshmëri, rezistente ndaj lagështirës dhe kundër korrozionit.



<p>37</p>	<p>Dollap Metalik Individual me 3 dyer , Nënshtrësia: E bërë nga pllakë çeliku e mbështjellë me cilësi të lartë, 2. Trashësia:0.6mm, dyrt të rrshqitese nga te dy anet dhe me qeles, 3. Aksesorë harduerikë: Doreza është një lloj kombinimi i shtrëngimit të fshehur, i bërë nga aliazh alumini, i bukur dhe i qëndrueshëm; Të gjithë aksesorët harduerikë trajtohen me parandalimin e ndryshkut dhe korrozionit, duke përmbushur standardet kombëtare. 4. Procesi: Saldim me frekuencë të lartë, me sipërfaqe saldimi uniforme dhe konsistente, pa spërkatje, shkrije, Saldim Profesional, depërtim saldimi dhe dukuri të tjera. Të gjitha sipërfaqet kanë pesë shenja saldimi të dukshme. Sipërfaqja e kabinetit ka avantazhe të tilla si rezistenca ndaj presionit, forcë e lartë, e papërshkueshme nga uji, kundër ndotjes, rezistencë ndaj goditjes, jo deformueshmëri, rezistente ndaj lagështirës dhe kundër korrozionit.</p>	 
<p>38</p>	<p>Dollap Metalik Individual me 4 dyer , Nënshtrësia: E bërë nga pllakë çeliku e mbështjellë me cilësi të lartë, 2. Trashësia:0.6mm, dyrt të rrshqitese nga te dy anet dhe me qeles, 3. Aksesorë harduerikë: Doreza është një lloj kombinimi i shtrëngimit të fshehur, i bërë nga aliazh alumini, i bukur dhe i qëndrueshëm; Të gjithë aksesorët harduerikë trajtohen me parandalimin e ndryshkut dhe korrozionit, duke përmbushur standardet kombëtare. 4. Procesi: Saldim me frekuencë të lartë, me sipërfaqe saldimi uniforme dhe konsistente, pa spërkatje, shkrije, Saldim Profesional, depërtim saldimi dhe dukuri të tjera. Të gjitha sipërfaqet kanë pesë shenja saldimi të dukshme. Sipërfaqja e kabinetit ka avantazhe të tilla si rezistenca ndaj presionit, forcë e lartë, e papërshkueshme nga uji, kundër ndotjes, rezistencë ndaj goditjes, jo deformueshmëri, rezistente ndaj lagështirës dhe kundër korrozionit.</p>	 



39

Dollap Metalik Individual me 2 dyer , Nënshtrësia: E bërë nga pllakë çeliku e mbështjellë me cilësi të lartë,

2. Trashësia:0.6mm, dyrt te rrrhqitese nga te dy anet dhe me qeles,

3. Aksesorë harduerikë: Doreza është një lloj kombinimi i shtrëngimit të fshehur, i bërë nga aliazh alumini, i bukur dhe i qëndrueshëm; Të gjithë aksesorët harduerikë trajtohen me parandalimin e ndryshkut dhe korrozionit, duke përmbushur standardet kombëtare.

4. Procesi: Saldim me frekuencë të lartë, me sipërfaqe saldimi uniforme dhe konsistente, pa spërkatje, shkrirje, Saldim Profesional, depërtim saldimi dhe dukuri të tjera. Të gjitha sipërfaqet kanë pesë shenja saldimi të dukshme. Sipërfaqja e kabinetit ka avantazhe të tilla si rezistenca ndaj presionit, forcë e lartë, e papërshkueshme nga uji, kundër ndotjes, rezistencë ndaj goditjes, jo deformueshmëri, rezistente ndaj lagështirës dhe kundër korrozionit.





WOOD CORPORATION L.L.C

Nrb.811289562

Suharekë,Zona Industriale,Shirokë rr.Ukë Bytyqi, p.n.

Për emri AK : **Agjencia Qendrore e Prokurimit**



Titulli : **Furnizim me mobilje / LOT 3**






Kodi/Numri: **UA/2016-23-14297-1-1-1**





Data: 08.02.2024


Vendi: Suharekë,Kosovë.






KATALOGU me fotografi dhe me SPECIFIKACIONI TEKNIK detal




